

SHPALLJE E VENDI TË LIRË TË PUNËS**Forca Ajrore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Infermier bordi, në Qendrën Shëndetësore	Reparti Ushtarak nr. 3006, Farkë, Forca Ajrore	Farkë, Tiranë	E pacaktuar	Me dosje	-	25.06.2025	09.07.2025

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës:	Infermier bordi
2. Kodi i pozicionit:	FA3006D01006
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr. 3006, Farkë, Forca Ajrore
4. Vendi:	Farkë, Tiranë
5. Paga:	Trajtohet me pagë sipas VKM nr. 424, datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore , në sistemin e Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të Forcave të Armatosura të RSH, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pika 4, lidhja nr.6 (Vlera e elementit shtesë për kushte pune), për punonjësit e personelit “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet e përcaktuara në nënpikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi) (8,000) lekë, kreu II, pika 1 (Në spitalet rajonale/psikiatrike/bashkiake/ditore në qendrat spitalore rajonale dhe personelit civil, teknik i shkencave mjekësore, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të RSH të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes), lidhja nr.7 (Vlera e elementeve “paga për pozicion” dhe “shtesë për kushte pune” për punonjësit e personelit “mjekë dhe punonjësve të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknik të shkencave mjekësore”, në institucionet e tjera të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, të përcaktuara në nënpikat 3.5, të pikës 3, të këtij vendimi), kreu III (Për punonjësit civilë të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të RSH, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes (67.000) lekë, lidhja nr.8 (vlera e shtesës së nivelit të kuakualifikimit) (Grupi 1-2-3), (varion nga 10.000 deri në 14.000 sipas nivelit të kualifikimit), shtesa për vjetërsi 2%.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit:	25.06.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit:	09.07.2025
9. Mënyra e aplikimit:	Me intervistë

10. Dokumentat e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm;

- Kërkesën personale;
- Formularin e aplikimit;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dëftesën e shkollës së mesme të noterizuar me origjinalin;
- Diplomë e arsimit të lartë/listë notash të noterizuar me origjinalin;
- Fotokopje e patentës nëse ka;
- Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja;
- Raport mjekësor;
- Fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12, 2 copë;
- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim gjykata;
- Vërtetim prokurorie;
- Librezë pune;
- Jetëshkrim (CV);
- Formulari i vetëdeklarimit;

11. Kërkesa të përgjithshme të vendit të punës:

- Të ketë shtetësi shqiptare;
- Të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të plotësojë kriteret për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin e përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- Të mos jetë i denuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

10. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- Grada/Titulli: Nënoficer/Civil (NC);
- Arsimi : I lartë infermieri;
- Kualifikimi: Të ketë kryer kurse dhe kualifikime të ndryshme profesionale.
- Trajnimi: Të jetë i trajnuar në kurse dhe kualifikime të ndryshme në fushën që mbulon;
- Eksperienca në Punë: Mbi 3 vjet experience pune dhe aftësi të mira profesionale organizative, komunikuese dhe bashkëpunuese, si dhe për të punuar në grup;
- Gjuha e huaj: 1/1/1/1, STANAG 6001;
- Kërkesa të tjera specifike: Të ketë njohuri të mira në fushën e veprimit dhe përdorimin e programeve kompjuterik;
- Niveli i certifikatës së sigurisë; “E paaplikueshme”

11. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore:

- a) Të kryejë sigurimin e kujdesit shëndetësor të efektivit dhe të pacientëve të tjerë civil, gjatë kohës së qëndrimit të tij në bord si dhe kujdesin ndaj tyre gjatë shoqërimit në institucionin shëndetësor terciar.
- b) Të japë ndihmën e parë dhe të stabilizojë gjendjen shëndetësore të pacientit.
- c) Të ketë njohuri të mira të përdorimit të barnave dhe të materialeve të tjera ndihmëse mjekësore.
- d) Të ndihmojë mjekun gjatë vizitave mjekësore të efektivit.
- e) Të kryejë procedurat mjekësore (injeksione, matjet e presionit të gjakut, shpërndarjen e barnave sipas recetës së lëshuar nga mjeku i repartit).
- f) Të plotësojë dokumentacionin sipas kërkesave të rregullores.
- g) Të raportojë sipas shkallës hierarkike për çdo problem që mund të ketë gjatë kryerjes së detyrës.
- h) Të kryejë detyra shtesë në përshtatje me nevojat e punës kur i kërkohet nga eprori.

Përgjegjësitë: Përgjigjet për mbajtjen në gadishmëri të pajisjeve shëndetësore, kontrollin shëndetësor të personelit dhe plotësimin e dokumentacionit.

▪ **Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Ajrore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.

Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);
- intervistën e strukturuar me gojë;

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.